



**Sh.A.F.P Sigal Life UNIQA Group Austria sha**

**RAPORTI VJETOR 2016**

**Fondi I Pensionit Vullnetar SIGAL**

Raporti vjetor nuk është një ofertë ose reklamë për fondin e Pensionit SIGAL.

Ky raport përmban pasqyrat financiare të shoqërisë administruese dhe secilit prej fondeve që ajo administron për vitin 2016, të audituara nga shoqëria PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.



# PËRMBAJTJA

## **Sh.A.F.P Sigal Life UNIQA Group Austria sha**

Rreth nesh

Misioni

Vizioni

Vlerat dhe premtimi ynë

Organet drejtuese

Transparenca

Investimet

Performanca e Fondeve deri më 31.12.2016

Historiku Tarifës Administrative

## **Fondi i Pensionit VULLNETAR SIGAL**

Performanca e Fondit

Strategjia e Investimit



SH.A.F.P SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SHA– Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. është person juridik i themeluar më 21.01.2006 dhe i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 31.01.2006 me NUIS – K61423001P, me seli në Rr. “Ukraina e Lirë”, pas Kullave Binjake, midis Ambasadës së Kosovës dhe asaj Zvicerane (Pallati i Ri Teknoprojekt), Tiranë, me licencë nr. 2, datë 28.04.2016 lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, përfaqësuar nga Z. ELVIS PONARI, Administrator.

Shoqëria Administruese ka si objekt të aktivitetit të saj veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit privat dhe të aktiveve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, mbështetur në licencën nr. 2, datë 28.04.2016, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

#### **Shoqëria administruese ka nën administrim:**

- Fondi i Pensionit VULLNETAR SIGAL – Fond Pensioni Privat me Pjesëmarrje të Hapur, licencuar me vendim nr. 51 datë 30.03.2011 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

**Misioni** ynë është të ndihmojmë njerëzit që investimet e përditshme, sado të vogla, t’i kthejnë në ëndrrat e tyre, sado të mëdha. Ne punojmë me përgjegjësi sociale për një biznes që të rritet vazhdimisht dhe që kontribuon për një jetë cilësore për punonjësit tanë, partnerët dhe komunitetin tone. Qëllimi ynë është që ti sigurojmë të gjithë anëtarëve të fondeve SIGAL, mundësinë e një pensioni të përshtatshëm për të ruajtur standartin e jetesës sipas kërkesave, nevojave dhe pritshmërove të tyre, duke maximizuar përfitimet nëpërmjet administrimit të kujdesshëm të aseteve.

**Vizioni** ynë është të punojmë për suksesin dhe fuqizimin e pozitave tona financiare rajonale, duke u fokusuar në ruajtjen dhe forcimin e mëtejshëm të pozicionit tone në treg përmes qëndrueshmërisë financiare, produkteve dhe shërbimeve cilësore, profesionalizmit dhe transparencës përtë gjithë anëtarët tanë.

#### **Vlerat tona**

- ✓ Klienti është në qendër të vëmëndjes
- ✓ Respekt, përkujdesje, mirënjohje, tolerance dhe dëgjim aktiv
- ✓ Disiplinë, vetkontroll, sjellje model
- ✓ Entuziazëm, gadishmëri dhe punë me pasion dhe dashuri
- ✓ Kreativitet
- ✓ Integritet, përgjegjshmëri, sinqeritet dhe mbajtje e fjalës së dhënë
- ✓ Ambicie për progress, këmbëngulje, otimizëm dhe Qëndrim pozitiv
- ✓ Angazhim për exelencë dhe përmirësim I vazhdueshëm në çdo gjë që bëjmë.



**Premtimi** ynë është të punojmë sëbashku duke u bazuar në misionin dhe vlerat tona për të krijuar Deklaratën e premtimit e cila shpreh atë çfarë anëtarët presin prej nesh:

Ne do të:

- ✓ Jemi pranë jush për tju siguruar nivelin më të lartë të shërbimit.
- ✓ Veprojmë në interesin tuaj më të mirë dhe administrojmë investimet dhe pagesat e pensionit me profesionalizëm.
- ✓ Sigurojmë informacion të saktë në kohën e duhur dhe në menyrë konfidenciale.
- ✓ Kemi stafin dhe strategjinë e duhur për të administruar më mirë pensionin tuaj .
- ✓ Përfaqësojmë dhe mbrojmë interesat tuaja duke u siguruar që zëri juaj të dëgjohet.

## **Organet Drejtuese të Shoqërisë Administruese janë:**

### **I. Asambleja e Aksionarëve**

Asambleja e Aksionarëve përbëhet nga këta përfaqësues ligjorë të shoqërisë:

- 1. Edvin Hoxhaj**, Shoqëria “SIGAL LIFE UNIQA Group sh.a.
- 2. Avni Ponari**, CEO SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.

### **II. Këshilli i Administrimit**

Këshilli i Administrimit përbëhet nga 5 anëtarë:

- |                           |         |
|---------------------------|---------|
| <b>1. Adrian Totokoçi</b> | Kryetar |
| <b>2. Abdyl Sarja</b>     | Anëtar  |
| <b>3. Edvin Hoxhaj</b>    | Anëtar  |
| <b>4. Klement Mersini</b> | Anëtar  |
| <b>5. Elvis Ponari</b>    | Anëtar  |



**Këshilli i Administrimit** ka kompetencë kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare, zhvillimin e biznesit të shoqërisë administruese, miraton politikat financiare dhe politikat e investimit, emëron dhe shkarkon administratorët ose anëtarët e komitetit të investimit. Këshilli i Administrimit angazhohet që shoqëria administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit.

**Z. Adrian Totokoci**, vjen nga një eksperiencë e gjatë në fushën e menaxhimit dhe ekonomisë, me përvojë në pozicione drejtuese në institucione shtetërore të tregtisë së jashtme.

Z. Totokoçi është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik (1980-1985). Z. Totokoçi ka kryer studime pasuniversitare në Universitetin e Manhattan-it (1992-1993) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Aktualisht ai është:

- Administrator i Përgjithshëm, Kompania ALTO Sh.p.k, Përfaqësuese Zyrtare e Markës Toyota në Shqipëri.
- Administrator i Përgjithshëm, Kompania AVEL Sh.p.k, Përfaqësuese Zyrtare e Markës Peugeot në Shqipëri,
- Anëtar Bordi i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Japoni.

**Z. Abdyl Sarja**, në cilësinë e Drejtorit të Departamentit Juridik të shoqërisë më të madhe të Sigurimeve në Shqipëri “SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.” sh.a. ka një përvojë të mirë të vendosjes së standardeve organizative e ligjore të shoqërisë.

Z. Sarja prej vitit 2013 është Sekretar i Përgjithshëm i “SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.” sh.a.

Ai është diplomuar si Jurist në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (1996-2000). Z. Sarja ka titullin master në Të Drejtat Evropiane dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Francë (2003-2004) dhe Titulli i Avokatit (që nga viti 2005). Gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pas diplomimit, Z. Sarja ka punuar si Avokat Specialist pranë Këshillit të Qarkut, Tiranë (2000-2002); si Specialist në Sektorin Juridik në Departamentin e Mbështetjes Profesionale; (2002-2004), si Përgjegjës i Sektorit Juridik (2004-2005) dhe në fund si Drejtor i Drejtorisë Ligjore dhe Licencimit të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve (sot Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare) (2005-2006).



Z. Sarja është anëtar bordi i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.Kosovë (që nga viti 2008) dhe Kryetar i Komitetit Ligjor të Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë. Ai ka shërbyer edhe për dy mandate si Anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës.

Z. Abdyl Sarja nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

**Z.Edvin Hoxhaj**, Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë “SIGAL LIFE UNIQA GROUP sh.a. me një eksperiencë të pasur në fushën e sigurimeve në përgjithësi dhe atë të jetës e risigurimeve në veçanti.

Z. Edvin Hoxhaj është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik (1984-1988). Ai ka ndjekur Studime Postuniversitare për Vlerësimet e Pasurive të Paluajtshme në Universitetin Politeknik, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, në vitet 1993-1994.

Ai gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime në Shqipëri dhe jashtë vendit, kryesisht mbi Sigurimet (Jo Jetë dhe Jetë) dhe Risigurime si dhe për Menaxhim Biznesi.

Z. Hoxhaj e filloi karrierën e tij në industrinë e sigurimeve duke punuar në Institutin e Sigurimeve të Shqipërisë në Korrik 1992, ku ka mbajtur disa pozicione: Menaxheri i Zyrës së Sigurimit të Pronës (1992-1996); Drejtor i Departamentit Motorik (1996-1998) dhe Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm dhe Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës (1997-1999). Nisur nga përgatitja e plotë dhe përvoja e tij e gjatë, Z. Hoxhaj është kontribues në disa subjekte në tregun e sigurimeve në vend dhe në Ballkan.

Aktualisht është anëtar bordi i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a., Kosovë (që nga viti 2012)

Z. Edvin Hoxhaj nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

**Z.Klement Mersini** ka një formim e eksperiencë të pasur në fushën financiare.

Aktualisht, Z.Mersini mban postin e Drejtorit të Departamentit Financiar në kompaninë më të madhe të Sigurimeve në Shqipëri SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.

Z. Mersini është diplomuar pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në degën Financë – Kontabilitet (1994-1998), ndërsa ka vijuar studimet pasuniversitare dhe aktualisht është kandidat për PhD. Z. Mersini është Kontabël i Miratuar (që nga viti 2002) dhe Ekspert Kontabël i Autorizuar (që nga viti 2010). Ai gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime



në Shqipëri dhe jashtë vendit, kryesisht për mbikëqyrjen dhe raportimet në shoqëritë e sigurimit, menaxhimin e rrezikut, menaxhimin e aktiveve, Solvency 2, IFRS 4, IFRS 17, etj.

Z. Klement Mersini nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

**Z. Elvis Ponari** është Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive “Sh.A.F.P dhe S.I.K Sigal Life UNIQA Group Austria sha” sh.a.. Z. Ponari është inxhinier financiar me arsim pasuniversitar, zotëron master në Administrim Biznesi (MBA) në banka dhe sigurime dhe master shkencor (MSc) në Financë. Me një eksperiencë 10 vjeçare në sigurime në Vjenë, Austri, ku ka mbajtur pozicionin si Drejtor Rajonal në UNIQA Group Austria. Gjithashtu, Z. Elvis Ponari ka dhe një eksperiencë 3 vjeçare si drejtues në Bankën e Shqipërisë dhe më pas në rolin Drejtues Ligjor i kompanisë vendase ALBGAZ. Aktualisht, është dhe anëtar bordi tek SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a. në Kosovë.

Përpos ekspertizës, Z. Elvis Ponari ka qenë lektor në trajnime të shumta në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, menaxhimit të rrezikut, menaxhimit financiar dhe buxhetimit në universitete dhe në institucione financiare vendase dhe të huaja.

Z. Elvis Ponari, nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

## **Transparenca**

Shoqëria Administruese siguron një transparencë të vazhdueshme për anëtarët e fondit duke i informuar për situatën e aktiveve të tyre nëpërmjet:

- a) Sistemit duke mundësuar kontroll 24 orë në llogaritë individuale të anëtarëve në faqen e internetit [www.fondisigal.com.al](http://www.fondisigal.com.al), ku anëtarët me mjete elektronike të informohen në çdo kohë duke aksesuar llogarinë individuale për aktivet përfshirë vlerësimin e vlerës neto të aktiveve, totalin e ndryshimit të aktiveve për periudhën 12 -muajore, normën e kthimit nga investimi për fondin për periudhën 12-mujore, kthimin



nga investimi, që nga fillimi i pjesëmarrjes në fond, datat e kontributeve dhe transferimet e aktiveve të bëra nga ose në emër të anëtarit gjatë periudhës përkatëse.

b) Shoqëria administruese harton një dokumentin “Vërtetim për gjendjen e llogarisë së pensionit të anëtarit të fondit.”. për gjendjen e llogarisë së pensionit për çdo anëtar të Fondit të Pensionit Vullnetar SIGAL dhe SIGAL PRO. Vërtetimi i vihet në dispozicion çdo anëtar, pa pagesë, në formë elektronike, të paktën 1 (një) herë në vit. Krahas çdo informacioni në formë elektronike, anëtarëve u jepet edhe një kopje fizike me kërkesë të tyre.

Shoqëria administruese publikon vlerën neto të aktiveve dhe vlerën neto të kuotës së fondit në ditën e vlerësimit. Prospektin, raportet financiare të ndërmjetme (çdo 3-muaj), raportin vjetor të audituar (1herë/vit) ose botime të tjera të publikuara nga shoqëria administruese. Ky informacion publikohet në faqen zyrtare të shoqërisë administruese. Krahas çdo informacioni në formë elektronike, anëtarëve u jepet edhe një kopje fizike me kërkesë të tyre.

Shoqëria Administruese është gjithashtu në komunikim të vazhdueshëm me anëtarët si nëpërmjet e-mail apo telefonatave duke i sqaruar çdo pyetje apo kërkesë që lidhet me investimin e tyre.

## **Investimet**

Objektivi i investimit të fondeve që Shoqëria Administruese Adminsitron është:

- Investimi në tituj të Qeverisë shqiptare me afat të gjatë gjë e cila maksimizon kthimin afatgjatë të investimit.
- Investimi në tituj të Qeverisë Shqiptare e cila siguron normë më të lartë kthimi dhe maksimizim të fitimit të Fondit të Pensionit.
- Administrim i kujdesshëm dhe konservator i rrezikut të investimit. Për këtë arsye objektivi i investimit është investimi në instrumente financiare me rrezik sa më të ulët.
- Portofoli i investimeve do të ndërtohet nga obligacione afatgjatë të emetuara dhe garantuara nga Republika e Shqipërisë me synimin e maksimizimit të fitimit të kushtëzuar nga kufijtë e rrezikut dhe likuiditetit.

## Performanca e Fondeve më 31.12.2016

Kthimi neto nga Investimi	Fondi SIGAL
31.12.2015 - 31.12.2016	4.34%

Kthimi nga investimi i fondeve që shoqëria Administruuese ka nën administrim të saj kanë një rritje të kthimit nga investimi me ritme të kënaqshme dhe kjo falë një strategjie të menaxhimit efikas bazuar në analiza dhe vendimarrje të orientuar drejt performancës afatgjatë.

### Tarifës Administrative

Aktualisht tarifa administrative e Fondit të Pensionit Sigal është 3.00%. Shoqëria administruuese për t'ju përmbajtur sa më mirë misionit, vizionit dhe vlerave të saj synon që në vitet e ardhshme të rishikojë tarifën e administrimit duke e ulur atë në mënyrë të ndjeshme.

### Fondi i Pensionit Vullnetar SIGAL

Fondi i Pensionit Vullnetar SIGAL - është aktualisht fondi më i madh në tregun e Pensioneve private në Shqipëri me një vlerë asetesh 672,690,158 lekë. Aktivitetet e Fondit janë tërësisht të ndara prej aktiveve të tjera të administruara nga Shoqëria Administruuese dhe nuk mund të jenë objekt i pretendimeve ose ekzekutimeve, të kryera në emër dhe për llogari të kreditorëve të Shoqërisë Administruuese.

#### Të dhënat kryesore për Fondin në 31 Dhjetor 2016

Vlera Neto e Aseteve	672,690,158 Lekë
Çmimi i Kuotës	1,296.9325 Lekë
*Fitimi vjetor (31/12/15-31/12/16)	4.34 %



Fondi i Pensionit Vullnetar SIGAL ka për qëllim të maksimizojë kthimin afatgjatë të investimit nëpërmjet administrimit të kujdesshëm dhe konservator të rrezikut të investimit. Asetet e Fondit do të investohen me synim për të rritur kthimin nga investimi për anëtarët e tij dhe për t'ju siguruar atyre një të ardhme të sigurt.

## Strategjia e investimit

Të gjitha investimet kryhen në mënyrë të matur dhe të përgjegjshme duke mbajtur parasysh ruajtjen e vlerës së kapitalit dhe të një niveli të mjaftueshëm likuiditeti, për të përmbushur të gjitha detyrimet e tashme dhe të ardhshme në momentin që këto të fundit bëhen të pagueshme.

Fondi investoi gjatë vitit 2016 kryesisht në obligacione afatgjatë të shtetit shqiptar për shkak të kohës së largët të daljes në pension si dhe për shkak të maksimizimit të fitimit për anëtarët e fondit.

Në 31 dhjetor 2016 struktura e portofolit të investimeve të Fondit të Pensionit Vullnetar SIGAL paraqitet si më poshtë:

<b>Tituj Të Qeverisë Shqiptare (Obligacione)</b>	645,779,458	95.76%
<b>Mjete monetare (Llogari rrjedhese)</b>	28,598,591	4.24%

## Performanca

Aktivet neto të Fondit të pensionit Vullnetar SIGAL më 31.12.2016 arritën vlerën 672,690,158 lekë me një rritje prej 43.59% krahasuar me vitin 2015.

Kthimi nga Investimi për vitin e fundit 31.12.2015-31.12.2016 ka qënë 4.34% ndërkohë kthimi që prej fillimit aktivitetit është 4.62%

## Tregues të Riskut në 31 Dhjetor 2016

FONDI	Devijimi standart	Treguesi sistetik i rrezikut	Kthimi Mesatar Vjetor	Kthimi që prej fillimit
Fondi Pensionit Vullnetar SIGAL	0.0097%	1	4.34%	4.62%

**Treguesi i riskut sintetik** në tabelë jep informacion mbi nivelin e rrezikut të fondit (nga niveli 1, rrezik shumë i ulët deri në nivelin 7, rrezik shumë i lartë). Fondet e Pensionit Privat kanë një nivel rreziku 1, që do të thonë rrezik i ulët, profil shumë konservator dhe të qëndrueshëm. Fondi i Investimit Sigal Invest ka një nivel rreziku 3 që do të thotë rrezik mesatar, më dinamik dhe më i përshtatshëm për investitorët që pranojnë më shumë rrezik në këmbim të potencialit më të lartë për kthim.

Administrimi i Riskut kryhet nga një njësi e pavarur e cila mat, monitoron, dhe raporton në Këshillin e Administrimit, Komitetin e Investimit dhe AMF respektimin e limiteve dhe treguesit e ndryshëm të riskut. Ky departament është i ngarkuar me identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve të lidhura me investimet. Kjo përfshin analizën e rreziqeve financiare, operacionale, dhe të tregut, që mund të ndikojnë në kthimin e investimeve.

Për fondin e Pensionit Vullnetar SIGAL treguesit kanë qenë stabil dhe luhatshmëria ka qenë e ulët, të gjitha investimet e fondeve mbahen deri në maturim.

**Devijimi Standart** mat variacionin e kthimeve pra rrezikun total të Fondit. Fondi i Pensionit Vullnetar SIGAL është një fond i qëndrueshëm dhe thajse pa luhatje të kthimeve.



Pasqyrat Financiare  
Më 31.12.2016

## Fondi i Pensioni Vullnetar SIGAL

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016

• Pasqyra e Aktiveve të Fondit 31.12.2016

	Lek	
	Periudha e meparshme 31.12.2015	Periudha aktuale 31.12.2016
<b>1. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	46,295,406	28,598,591
<b>2. Investime</b>	422,176,657	645,779,458
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>	<b>468,472,063</b>	<b>674,378,049</b>
4. Detyrime ndaj shoqërisë administruese	0	1,687,891
5. Detyrime nga ndryshimi i anëtarësisë	0	0
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>	<b>0</b>	<b>1,687,891</b>
AKTIVET NETO TË FONDIT TË PENSIONIT	468,472,063	672,690,158
NUMRI I KUOTAVE TE FONDIT TE PENSIONIT	376,886	518,678
<b>AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË PENSIONIT</b>	<b>1,243.0088</b>	<b>1,296.9325</b>

• Pasqyra e Veprimtarisë 31.12.2016

	Lek	
	Periudha meparshme 31.12.2015	Periudha Aktuale 31.12.2016
<b>Të ardhura nga interesat e letrave me vlere Obligacione</b>	27,808,556	40,321,146
<b>Të ardhura nga interesa depozita bankare</b>	236,052	122,690
<b>TOTALI I TË ARDHURAVE NGA INVESTIMET</b>	<b>28,044,608</b>	<b>40,443,837</b>
Diferenca negative të kurseve të këmbimit nga mjetet monetare	18,803	64,656
Tarifa për shoqërinë administruese	11,417,685	16,804,094
<b>Totali Shpenzimeve</b>	<b>11,436,488</b>	<b>16,868,750</b>
<b>TOTALI I FITIMEVE (HUMBJEVE)</b>	<b>16,608,121</b>	<b>23,575,087</b>

• Pasqyra e ndryshimeve te aktiveve neto 31.12.2016

	Periudha e meparshme 31.12.2015	Periudha aktuale 31.12.2016
<b>RRITJA (ZVOGËLIMI) I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT</b>	<b>16,608,121</b>	<b>23,575,087</b>
Kontribute nga anëtarët e fondit	149,882,833	192,802,376
Tërheqje e aktiveve	(8,577,146)	(12,159,367)
<b>Rritja në Aktivet e Fondit</b>	<b>157,913,807</b>	<b>204,218,096</b>
Kuota të pensionit të emetuara mbi bazën e kontributeve	123,061	151,344.0000
Tërheqje të kuotave	(7,103)	(9,552)
<b>NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT</b>	<b>115,958</b>	<b>141,792</b>

Bazuar në informacionet e mësipërme, Viti 2016 ishte një vit me performancë të qëndrueshme të fondeve të pensionit si dhe Fondit të Investimit. Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal vazhdoi të ofrojë kthime të qëndrueshme me rrezik shumë të ulët, duke përmbushur objektivin e tij primar, ruajtjen dhe rritjen graduale të kursimeve të anëtarëve për një pension të sigurt dhe të qëndrueshëm.

Të gjithë treguesit e rrezikut, kthimit dhe kohëzgjatjes janë monitoruar rregullisht dhe janë menaxhuar në përputhje me strategjinë e investimit dhe objektivave staturore të fondeve. Përgjatë vitit 2016, menaxhimi profesional, transparencja dhe përkushtimi ndaj sigurisë së investimeve kanë mbetur në qendër të veprimtarisë tonë.

Duke parë përpara, synojmë të vijojmë me të njëjtin standart profesional, të zgjerojmë bazën e anëtarëve dhe të ofrojmë zgjidhje të përshtatura me nevojat në ndryshim të investitorëve tanë.